

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË – DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE** Gjyqtarja Lirije Kaferxholli me Sek.juridike Belkize Gashi në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Jemin Selim Zeqiri nga fsh Mushtisht, për shkak të kundërvajtjes nga neni 5 dhe 6 paragraf 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, si dhe në bazë të nenit 73, 195 dhe 199 të Ligjit mbi kundërvajtje, me dat. 22.10.2013 merrr këtë:

#### A K T V E N D I M

**I PANDEHURI:** Jemin Selim Zeqiri I lindur me dt. 07.11.1960 në fsh. Mushtisht Komuna e Suharekës, ku dhe tani jeton, I martuar, ka të kryer fakultetin e mjeksisë, stomatolog, gjerë me tani kinse jo i denuar.

#### Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S

Sepse si zyrtar I lartë publik – Këshilltar i ansambles komunale në Suharekë nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë për vitin 2011 në Agjencionin Kunder Korrupsionit në Prishtinë në afat ligjor prej dt. 01 deri 31.03.2012 sipas kërkesës së Agjencionit kunder korrupsionit.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 paragraf 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publik, e me aplikimin e të njëjtit konform nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtje i shqiptohet:

#### Q O R T I M I

Të pandehurit i shqiptohet masa e **QORTIMIT** në bazë të nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet. Shpenzimet e procedurës i barte gjykata.

Me nga një egzemplar të këtij aktvendimi të njoftohet parashtresi i kërkesës dhe i pandehuri.



#### A r s y e t i m

Me kërkesën e Agjencionit Kundër Korrupsionit në Prishtinë me nr. 01 /2508/12 të dt. 13.07.2012 është ngritur procedura kundërvajtëse ndaj të pandehurit me motivacion se kanë kryer kundërvajtje nga neni 5 dhe 6 paragraf 1.3 dhe neni 9 të Ligjit për deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarinimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar.

Gjykata me Aktvendimin me nr.7390/12 të dt. 14.03.2013 të pandehurin e shpalli përgjegjes dhe e denoi me gjobe në të holla në shumë prej 400 (Katerqindë) Euro, kunder këtij aktvendimi I pandehuri ka parashtuar ankesë Gjykates së Apelit në Prishtinë - Divizionit për Kundërvajtje. Kjo gjykata e abrogoj aktvendimin e kesaj gjykate dhe lënden ia kthejë në plotesim të procedurës dhe rivendosje. Gjykata duke vepruar sipas rekomandimit të Gjykates së Apelit në Prishtinë – Divizionit për Kundërvajtje muar në pyetje përfaqësuesin e AKK - Agron Behrami në cilësinë e dëshmitarit I cili ndër të tjerat theksoj se në hyrje në fuqi të Ligjit të ri për deklarinimin, prejardhjen e pasurisë 04/L-050 kanë për obligim që edhe Këshilltarët Komunal të bëjnë deklarinimin, prejardhjen e pasurisë gjatë muajit Mars të gjdo viti kalenderik. AKK ka filluar pregaditjet për deklarinimin e rregullt vjetor të pasurisë si dhe deklarinimin sipas kërkesës së agjencisë për zyrtar të lartë publike të cilët nuk kanë patur me heret obligim për deklarinimin e pasurisë, njoftimet I kemi shpërndar të gjithë zyrtarëve kontaktues nëpër institucione, zyrtarët kontaktus kanë për obligime të njoftojnë zyrtarët e lartë publik me pajtim të nenit 4 të Ligjit të lartë përmendur. AKK ka kontrolluar listat e zyrtarëve të lartë publik dhe ka konstatuar se zyrtari I lartë publik Jemin Zeqiri nuk ka paraqitur deklarinimin e pasurisë sipas kërkesës së AKK –së, andaj kemi paraqitur kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse ndaj tij për kundërvajtje të kryer nga neni 5 dhe 6 paragrafi 1.3 dhe neni 9 dhe neni 17 paragrafi 1.3 nga se i njëjti nuk ka bërë deklarinimin e pasurisë prej 1 deri me 31 mars 2012 për vitin paraprak pranë AKK-së – në Prishtinë. Në nuk kemi qenë të njoftuar se i njëjti ka patur probleme shëndetësore gjatë kohës së deklarinimit të pasurisë.

Gjykata muar në pyetje dëshmitarin Ragip Sadikaj si zyrtar I pikës kontaktuse në mes të Komunes së Suharekës dhe AKK –së -Prishtinë. Sa I perket kërkesës e cila është e ngritur kundër Jemin Zeqiri nga Mushtishti për mos deklarinim të pasurisë deklaroi se materialin e nevojshëm sebashku me formularin e AKK-së – Prishtinë dhe njoftimin punetori i Kuvendit të Komunes- Fatmir Kicaj ia ka dorzuar një antarit të familjes së të pandehurit në fjalë,

Andaj gjykata pas administrimit dhe vlerësimit të të gjitha provave konstatoi se i pandehuri ka kryer kundërvajtje siqë është e cekur në dispozitiv të këtij aktvendimit, andaj për një veprim të tillë e shpalli

 AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGJENCIA PËR TIV KORRUPSIONE ANTI-CORRUPTION AGENCY		
Dep.	DPE/DMP	Nr. Prot.
Dep.		03-3774/13
Dep.		Prot. No.
Nr. i faq.		E-ata
Proj. shprehja	02	Datum
Nr. përcakt.		Date
		07-11-2013
PRISHTINE		

03-3774/13/02  
fuz

pergjegjes mirëpo konform nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtje ia shqiptoj masën e QORTIMIT me bindje so do të arrihet efekti i denimi tek I pandehuri.

Me rastin e shqiptimit të denimit janë vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese në të cilat është kryer kundërvajtja, se është hera e pare qe i pandehuri ka kryer keso lloj kundervajtje, pra duke patur parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese e në pajtim me nenin 10 të Ligjit mbi Kundërvajtje ia shqiptoj **QORTIMIN** me bindje se do të arrihet qellimi i denimit tek i pandehuri dhe do të ndikoj pozitivisht që në të ardhmën mos të perseris vepra të tilla kundërvajtëse, Gjykata si rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të denimit muar parasysh se I pandehuri per herë te parë ka kryer keso kundrvajtje , se I pandehuri e ka deklaruar pasurinë me dt,30.05.2012 gjykates ia prezentoj Vertetimin te leshuar nga AKK Prishtinë , si dhe gjendjen shëndetsore te tij , ndersa si rrethanë rënduese gjykata muar peshën e kundervajtjes se kryer.

Më sa u cekë më lartë u vendos si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË - DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE.**

Sek.juridike  
Belkize Gashi



Gjykatja  
Belkize Gashi

**UDHZIME JURIDIKE:** Pala e pa kënaqurë kundër Këtij Aktvendimi, ka të drejtë ankese Gjykates së Apelit në Prishtinë, - Devizioni per Kundervajtje në afat prej 8 ditësh, pas marrjes së të njejit nëpërmes të kësaj Gjykate.